



Zhvillohet workshop-i "Bujqësia e zgjuar në Shqipëri, arritje dhe sfida për të ardhmen"

Faqe 12



Tregtimi i vajit ekstra të virgjër në vend, kreu i shoqatës së Agrobiznesit: Nuk ka fabrika për ambalazhimin e qelqit dhe depozita inoksi për ruajtjen e vajit

Faqe 5



Circular City Labs Tirana prezanton zgjidhje inovative për qytete të jetueshme në kuadër të Javës Globale të Sipërmarrjes

Faqe 2



AGROBIZNESI

Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh, Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR
Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i dytë i muajit nëntor 2024

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 498
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

INTEGRIMI EVROPIAN DHE RËNDËSIA E INFRASTRUKTURËS SË CILËSISË

FORUMI I 2-TË KOMBËTAR I CILËSISË DHE STANDARDEVE: NJË HAP DREJT TË ARDHMES SË QËNDRUESHME PËR SHQIPËRINË

Forumi i 2-të Kombëtar i Cilësisë dhe Standardeve, një aktivitet madhor që mbledh liderë të shquar, vendimmarrës, ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë të industrisë dhe përfaqësues nga sektori publik dhe privat. Ky forum, me temën qendrore "Fuqizojmë Ndryshimin: Cilësi dhe Standarde për Njerëzit, Planetin dhe Prosperitetin," u organizua nga UNIDO, në bashkëpunim me SECO-n

Programi Global Për Cilësi dhe Standarde

UNITED NATIONS INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO



Rama: Buxheti për bujqësinë i pesëfishuar, mbështetje për mbi 500 projekte në agroturizëm



Faqe 5

SIGURI DHE STANDARDE

1 mld euro eksporte në 2030 dhe zgjerim i tregjeve - Forumi i UNIDO / Masat për të shmangur refuzimet në kufi të prodhimeve shqiptare

Faqe 2

HISTORI



Kontributi i fshatarësisë shqiptare në mbrojtjen e atdheut, në pesë vitet e Luftës së Dytë Botërore

Prof. Ass. Enver Isufi, Agronom në Mbrojtjen e Bimëve dhe Bujqësinë Biologjike

Faqe 10

TEMA TË DITËS

- Fondi i Ambasadorëve: Afati për projektet e reja përfundon në 13 dhjetor Fq.6
- Dredha pret në takim ambasadoren e Kinës, në fokus zhvillimi i turizmit Fq.6
- Investitorët austriakë, interes për të zgjeruar praninë në tregun shqiptar Fq.6
- Duhani shqiptar drejt Bosnjes - Në 10 muaj janë eksportuar rreth 140 ton Fq.6
- Kalendarit bujqësor, muaji dhjetor 2024 - Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari Fq.13

PROJEKT NË BUJQËSI

USAID mbështet rritjen e konkurrueshmërisë në bujqësi



Faqe 12

TEMA TË DITËS

1 mld euro eksporte në 2030 dhe zgjerim i tregjeve - Forumi i UNIDO / Masat të për shmangur refuzimet në kufi të prodhimeve shqiptare

Prodhuesit shqiptarë përballen me refuzimin e produkteve bujqësore në kufi, kthimin apo asgjësimin e tyre, për shkak të mungesës së cilësisë dhe standardeve duke u shkaktuar humbje të madhe ekonomike si dhe duke cenuar objektivin e Shqipërisë për të arritur 1 miliardë euro eksporte bujqësore në vitin 2030.

Në një dekadë, konkretisht përgjatë periudhës 2010 – 2020, referuar analizës së refuzimeve të produkteve shqiptare në kufi, të ndërmarrë nga UNIDO, më shumë se gjysma e totalit të refuzimeve (58%) erdhi nga tregu i BE-së, ndërsa Kina përmbente një të tretën e tyre (31%).

Forum i dytë Kombëtar mbi Cilësinë dhe Standardet 2024 i organizuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial (UNIDO) në partneritet me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit trajtoi sfidat me të cilat përballen këto biznese për të përmbushur standardet ndërkombëtare si dhe masat që po merren për forcimin e infrastrukturës së cilësisë, me qëllim rritje e eksporteve dhe zgjerimin e hartës ku shkojnë prodhimet "Made in Albania".

Dorina Nati, Menaxhere e Programit Global, GOSP:

"Për të shfrytëzuar më së miri potencialin e bujqësisë shqiptare, duhet të trajtojmë sfidat që kanë të bëjnë me përputhshmërinë duke pasur parasysh forcimin e infrastrukturës. Shqipëria mund të rrisë konkurrueshmërinë e produkteve të saj dhe sigurinë për konsumatorët. Refuzimet në kufi është një çështje kritike për ti trajtuar përmes forcimit të infrastrukturës përkatëse. UNIDO ka një rekord prej 15 vitesh sa i takon rritjes se

standardeve në shume vende. Strategjia e zhvillimit të infrastrukturës së cilësisë së prodhimeve shqiptare për Shqipërinë që të sigurojë infrastrukurën e cilësisë e cila do



infrastrukturës së cilësisë së UNIDO shkon drejt zhvillimit të qëndrueshëm. Duhet ta shohim infrastrukturën e cilësisë si një platformë për të gjetur zgjidhje. Infrastruktura e cilësisë së shëndetshme do të jetë një instrument i fuqishëm për të arritur objektivat ambicioze që Shqipëria ka vendosur për qytetaret shqiptarë".

Programi Global i Cilësisë dhe Standardeve (GSQP) në Shqipëri, mbështetur nga qeveria zvicerane përmes Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO), dhe zbatuar nga UNIDO, po asiston prodhuesit e vegjël dhe të mesëm në vend që të rrisin cilësinë edhe standardet e produkteve të tyre, në mënyrë që të aksesojnë tregjet evropiane dhe me gjerë, si dhe të shmangin refuzimet në kufi.

Ruth Huber, Ambasadore e Zvicrës në Shqipëri:

"Ky forum është një hap i rëndësishëm në punën e përbashkët për të mbështetur ekonominë e Shqipërisë dhe hap edhe mundësi të reja ekonomike duke krijuar një fushë të re për produkte shqiptare që të lulëzojnë në tregjet europiane, prandaj është e rëndësishme

te forcoje dhe konkurrueshmërinë që do të sjellë me shume vëllime të eksporteve. Për bujqësinë dhe prodhuesit duhet të mbahet cilësia, ndërkohë që kërkohet dhe sasia. Për qeverinë sfida është të ndërtohet infrastruktura cilësore dhe të jenë mekanizmat kontrolluese.

Fiona McCluney, Përfaqësues e përherhme e OKB, Shqipëri:

"Cilësia dhe standardet nuk kanë të bëjnë thjeshtë me kërkesa, por ndikojnë në rritjen ekonomike dhe barazinë sociale. Nisma e përbashkët nga UNIDO dhe SECO është një program që funksionon në të gjithë botën për të forcuar kapacitetet e SME-ve dhe për të lehtësuar qasjen e tyre në tregje si në nivel vendi ashtu dhe në nivel global".

Forum i bëri bashkë mbi 200 pjesëmarrës nga një spektër i ndryshëm palësh të interesuara duke inkurajuar bashkëpunimin për të përmirësuar Infrastrukurën e Cilësisë në dritën e avancimeve teknologjike dhe dinamikave të tregut. Programi Global i Cilësisë dhe Standardeve (GOSP), është një iniciativë e gjerë që mbështet 14 vende në mbarë botën, përfshirë Shqipërinë.

Kuçi: Ekspertizë lituaneze për menaxhimin e fondeve të BE-së

Drejtoresha e përgjithshme e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (AZHBR), Ardita Kuçi, priti në një takim pune drejtorin e përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Pagesave të Lituaniës (NMA), Fortunatas Dirgincius dhe zv.drejtorin e përgjithshëm, Tomas Orlickas.

Kuçi bëri të ditur se, takimi u fokusua në shkëmbimin e përvojave dhe ekspertizës për identifikimin dhe parandalimin e risqeve, një komponent kyç për menaxhimin efektiv dhe të qëndrueshëm të fondeve të Bashkimit Evropian të dedikuara për sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

"Theksuam gjithashtu rëndësia e harmonizimit të praktikave të menaxhimit të fondeve me standardet më të

mira të BE-së", u shpreh ajo.

Në përfundim, palët nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi që synon zhvillimin



e aktiviteteve të përbashkëta, përfshirë shkëmbimin e ekspertizës, organizimin e seminareve, trajnimeve dhe vizitave studimore.

Sipas saj, kjo marrëveshje përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt rritjes së kapaciteteve institucionale dhe

forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional për të siguruar administrimin efektiv të fondeve që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë.

Circular City Labs Tirana prezanton zgjidhje inovative për qytete të jetueshme në kuadër të Javës Globale të Sipërmarrjes

Circular City Labs Tirana ka shpallur gjashtë projek-

ekonomisë qarkulluese në qytete. Ministrja e Shtetit për Sipër-

idetë e tyre në Tiranë gjatë gjashtë muajve të ardhshëm.



tet fituese të bizneseve dhe startup-eve të cilat ofrojnë zgjidhje të qëndrueshme për transformimin e sistemeve të paketimeve të ripërdorshme dhe promovimin e ekonomisë qarkulluese në qytete.

Aktiviteti u zhvillua në kuadër të Javës Globale të Sipërmarrjes, duke përmbyllur një program akselerimi 4-mujor që sjell për here të parë në Shqipëri programin Global Circular City Lab, i mbështetur nga Bashkimi Evropian, Qeveria Gjermane, dhe Bashkia e Tiranës, përmes projekteve Circular City Labs, BE për Ekonominë Qarkulluese dhe Qytete të Jetueshme, dhe BE për Inovacionin.

Projektet fituese, të cilat do të mbështeten me grante për të pilotuar idetë e tyre në Tiranë, përfshijnë: Eliminimin Reduktimit e paketimeve plastike në kozmetikë, kulinari apo njësi tregtimi; Prezantimin e sistemit për ripërdorimin e shisheve të qelqit në birrari; Pastrimin ekologjik të veshjeve për të ulur ndotjen në mjedis; si dhe organizimin e aktiviteteve kulturore dhe sociale duke përdorur materiale të ricikluara dhe miqësore me mjedisin.

Në Kuadër të këtij aktiviteti Circular City Labs Tirana, ka shpallur gjashtë projektet fituese të bizneseve dhe startup-eve të cilat ofrojnë zgjidhje të qëndrueshme për transformimin e sistemeve të paketimeve të ripërdorshme dhe promovimin e

marrjen, Delina Ibrahim, theksoi mbështetjen e qeverisë për projekte inovative në fushë e



ekonomisë qarkulluese.

"Ekonomia qarkulluese është e ardhmja për qytetet tona. Përmes iniciativave si Circular City Labs Tirana, duke nxitur inovacionin dhe duke krijuar mundësi të reja ekonomike Shqipëria po dëshmon përkushtimin për ndërtimin e një të ardhmeje të qëndrueshme," tha Ministrja e Shtetit për Sipërmarrjen, Delina Ibrahim, në fjalën e saj.

Përfaqësues të Delegacionit të Bashkimit Evropian dhe Ambasadës Gjermane vlerësuan bashkëpunimin mes qeverisë, bizneseve dhe komuniteteve për të adresuar sfidat e menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve.

Projektet fituese do të mbështeten me grante deri në vlerën 50 000 euro të cilat do t'u mundësojnë të pilotojnë

një ekonomi të drejtuar nga inovacioni, qarkullueshmëria dhe e bazuar në informacion e njohuri, Bashkimi Evropian, Gjermania dhe Qeveria Suedeze bashkëpunojnë me Bashkinë e Tiranës nëpërmjet tre projekteve: (1) Circular City Labs (2) BE për Ekonominë Qarkulluese dhe Ekonomia Qarkulluese për Zhvillim të Qëndrueshëm Urban dhe (3) BE për Inovacion. CCL Tirana implementohet nga Destil Creative Hub, Co-Plan, Institutin për Zhvillimin e Habitatit, dhe Universitetin POLIS.

Ky projekt përforcon potencialin e Shqipërisë për të qenë një model në ekonominë qarkulluese dhe në ndërtimin e qyteteve të jetueshme për gjeneratat e ardhshme.



UNIDO

INTEGRIMI EVROPIAN DHE RËNDËSIA E INFRASTRUKTURËS SË CILËSISË

FORUMI I 2-TË KOMBËTAR I CILËSISË DHE STANDARDEVE: NJË HAP DREJT TË ARDHMES SË QËNDRUESHME PËR SHQIPËRINË

Forumi i 2-të Kombëtar i Cilësisë dhe Standardeve, një aktivitet madhor që mbledh liderë të shquar, vendimmarrës, ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë të industrisë dhe përfaqësues nga sektori publik dhe privat. Ky forum, me temën qendrore “Fuqizojmë Ndryshimin: Cilësi dhe Standarde për Njerëzit, Planetin dhe Prosperitetin,” u organizua nga UNIDO, në bashkëpunim me SECO-n

Tirana mirëpriti Forumin e 2-të Kombëtar të Cilësisë dhe Standardeve, një aktivitet madhor që mbledh liderë të shquar, vendimmarrës, ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë të industrisë dhe përfaqësues nga sektori publik dhe privat. Ky forum, me temën qendrore “Fuqizojmë Ndryshimin: Cilësi dhe Standarde për Njerëzit, Planetin dhe Prosperitetin,” u organizua nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial (UNIDO), në bashkëpunim me Sekretariatit e Shtetit Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO).



Forumi u mbajt si pjesë e Programit Global të Cilësisë dhe Standardeve, një iniciativë e mbështetur nga Qeveria Zvicerane për të forcuar infrastrukturën e cilësisë në vendet partnere. Edicioni i këtij viti kishte për qëllim avancimin e qëndrueshmërisë, gjithëpërfshirjes dhe cilësisë si shtylla themelore të zhvillimit të qëndrueshëm dhe integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Eventi mblodhi mbi 200 pjesëmarrës, përfshirë përfaqësues të nivelit të lartë nga qeveria, NVM-të, udhëheqës ndërkombëtarë, politikëbërës dhe ekspertë teknikë. Ndër folësit kryesorë ishin:

- **Zn. Dorina Nati**, përfaqësuese nga UNIDO në Vjenë, e cila vuri në dukje rëndësinë e qasjes sistematike ndaj cilësisë dhe standardeve.

- **Sh.S.Znj. Fiona McCluney**, Përfaqësuese e Përhershme e OKB në Shqipëri, e cila theksoi ndërlidhjen mes zhvillimit të qëndrueshëm dhe përmirësimit të infrastrukturës së cilësisë.

- **Sh.S.Znj. Ruth Huber**, Ambasadorja e Zvicrës në Shqipëri, e cila ndau përvojën zvicerane mbi fuqizimin e cilësisë dhe standardeve si një themel për zhvillim ekonomik dhe social.

TEMATIKA KRYESORE DHE RËNDËSIA E FORUMIT

Forumi ofroi një platformë unike për të diskutuar rolin e infrastrukturës së cilësisë në avancimin e zhvillimit të qëndrueshëm, integrimin në tregjet globale dhe përmbushjen e standardeve të BE-së. Në fokus ishte përmirësimi i metrologjisë, standardizimit, akreditimit dhe vlerësimit të konformitetit – komponentët kyç që sigurojnë përputhshmërinë e produkteve dhe shërbimeve me standardet ndërkombëtare.



Në këtë kontekst, infrastruktura e cilësisë shihet jo vetëm si një parakusht për aksesin në tregjet ndërkombëtare, por edhe si një katalizator për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm dhe inovacionin.

FORCIMI I NVM-VE DHE PËRBALLJA ME SFIDAT

Një tematikë tjetër kyçe e forumit ishte roli i NVM-ve, veçanërisht në sektorin e bujqësisë, si promotorë të inovacionit dhe praktikave të qëndrueshme. Megjithatë, NVM-të shpesh përballen me sfida të tilla si burime të kufizuara dhe mungesë aksesit në teknologji të avancuara. Forumi trajtoi mënyrat se si dixhitalizimi mund të shërbejë si një zgjidhje praktike për modernizimin e proceseve dhe përmirësimin e konkurrencës në treg.

INTEGRIMI EVROPIAN DHE RËNDËSIA E STANDARDIZIMIT

Përafrimi me standardet evropiane u nënvizua si një parakusht i domosdoshëm për integrimin e Shqipërisë në tregun e Bashkimit Evropian. Ky proces jo vetëm që garanton përputhshmërinë me kërkesat rregullatore të BE-së, por edhe siguron konkurrencën e produkteve shqiptare në tregun ndërkombëtar.

FUQIZIMI PËRMES BASHKËPUNIMIT DHE TEKNOLOGJISË

Një tjetër element i rëndësishëm i forumit ishte ndërlidhja e cilësisë dhe dixhitalizimit, duke theksuar nevojën për një qasje bashkëpunuese midis qeverisë, industrisë dhe organizatave ndërkombëtare. Duke përfshirë teknologjitë e reja dhe qasjet inovative, forumi u përqendrua në krijimin e një peizazhi industrial që është konkurrues dhe i qëndrueshëm, duke përfshirë standardet e cilësisë dhe praktikën më të mira globale.



DORINA NATI NË FORUMIN E 2-TË KOMBËTAR TË CILËSISË DHE STANDARDEVE: CILËSIA DHE STANDARDET, SHTYLLA TË RRRITJES SË QËNDRUESHME PËR SHQIPËRINË



Në Forumin e 2-të Kombëtar të Cilësisë dhe Standardeve, **Zn. Dorina Nati**, përfaqësuese e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial (UNIDO), theksoi rëndësinë e jashtëzakonshme të cilësisë dhe standardeve si baza për rritjen e qëndrueshme të Shqipërisë dhe integrimin e saj në ekonominë globale.

Sipas saj, cilësia dhe standardet nuk janë thjesht konsiderata teknike, por janë shtylla thelbësore për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, duke ndihmuar Shqipërinë të realizojë potencialin e saj dhe të arrijë objektivin ambicioz të **1 miliard dollarë në eksporte deri në vitin 2030**.

PASURITË DHE SFIDAT E SHQIPËRISË

“Pasuria biologjike dhe klima e favorshme e Shqipërisë ofrojnë mundësi të jashtëzakonshme,” vuri në dukje znj. Nati. Megjithatë, për të përfituar plotësisht nga këto avantazhe dhe për të hyrë në tregjet ndërkombëtare, Shqipëria duhet të përballet me sfidat e infrastrukturës së cilësisë, gjurmueshmërisë dhe pajtueshmërisë me standardet ndërkombëtare.

Duke forcuar infrastrukturën e cilësisë, që përfshin standardizimin, metrologjinë, akreditimin dhe shërbimet e vlerësimit të konformitetit, Shqipëria mund të rrisë konkurrueshmërinë e sipërmarrjeve të saj dhe të garantojë sigurinë dhe cilësinë e produkteve të saj.

BESIMI DHE PAJTUESHMËRIA SI PARAKUSHT PËR EKSPORT

Znj. Nati nënvizoi se një infrastrukturë cilësie e fuqishme është thelbësore për të fituar besimin e tregjeve ndërkombëtare dhe për të reduktuar refuzimet në kufi, një pengesë e shpeshtë për rritjen e eksporteve shqiptare. Për më tepër, angazhimi ndaj cilësisë dhe standardeve është i lidhur ngushtë me aspiratat e Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

ROLI I UNIDO DHE QASJA HOLISTIKE PËR CILËSINË

Me një histori të gjatë mbi 50 vjet, **UNIDO** ka ndihmuar vendet në zhvillim të ndërtojnë sisteme të qëndrueshme të infrastrukturës së cilësisë. Znj. Nati theksoi se qasja e UNIDO është sistematike dhe holistike, duke përfshirë ndërgjegjësimin, zhvillimin e kapaciteteve dhe përforsimin e kapaciteteve të sektorit privat për të kuptuar dhe përdorur standardet, testimet dhe certifikimet.

Kjo qasje është në përputhje me **Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) të Kombeve të Bashkuara dhe kontribuon në shtyllat e Njerëzve, Prosperitetit dhe Planetit**.

CILËSIA: NJË KATALIZATOR PËR TRANSFORMIMIN E QËNDRUESHËM

Në diskutimin e saj, znj. Nati prezantoi një ndryshim paradigmë: infrastruktura e cilësisë nuk është më vetëm një mjet për të hyrë në tregje globale, por një katalizator i fuqishëm për zgjidhjet e qëndrueshme. Ajo ndihmon në:

- **Aspektin ekonomik**, duke nxitur inovacionin, përmirësuar konkurrueshmërinë industriale dhe krijuar rrugë për rritje gjithëpërfshirëse.

- **Aspektin social**, duke garantuar sigurinë ushqimore, mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve dhe promovuar shëndetin publik.

- **Aspektin mjedisor**, duke ofruar standarde dhe mekanizma verifikimi të domosdoshëm për veprime ndaj ndryshimeve klimatike.

Forumi i 2-të Kombëtar i Cilësisë dhe Standardeve: Një hap drejt të ardhmes së qëndrueshme për Shqipërinë

(Vijon nga faqja 3)

NJË PLATFORMË PËR ZGJIDHJE INOVATIVE

“Infrastruktura e cilësisë është një urë mes potencialit teknologjik dhe nevojave shoqërore,” tha znj. Nati. Ajo theksoi rëndësinë e krijimit të një kulture cilësie që përfshin të gjitha nivelet e shoqërisë – nga vendimmarrësit dhe institucionet deri te prodhuesit dhe konsumatorët.

RRUGËTIMI PËRPARA PËR SHQIPËRINË

Për të përmbushur potencialin e saj, Shqipëria duhet të ndërtojë një infrastrukturë cilësie të qëndrueshme që jo vetëm i plotëson standardet ndërkombëtare, por edhe adreson nevojat dhe sfidat unike të sektorëve të saj kryesorë. **Bashkëpunimi mes institucioneve shtetërore, sektorit privat, akademisë dhe partnerëve ndërkombëtarë është kyç për këtë rrugëtim.**

“E ardhmja e Shqipërisë qëndron në cilësinë,” përfundoi znj. Nati, duke theksuar se vetëm përmes një angazhimi të fortë ndaj cilësisë dhe standardeve, vendi mund të arrijë një zhvillim të qëndrueshëm dhe të fuqizojë pozicionin e tij në ekonominë globale.

RUTH HUBER NË FORUMIN E 2-TË KOMBËTAR TË CILËSISË DHE STANDARDEVE: “NJË SHQIPËRI MË KONKURRUESE DHE E QËNDRUESHME PËRMES CILËSISË DHE STANDARDEVE”



Në fjalimin e saj gjatë Forumit të 2-të Kombëtar të Cilësisë dhe Standardeve, **Sh.S. Ruth Huber**, Ambasadore e Zvicrës në Shqipëri, nënvizoi rëndësinë strategjike të zhvillimit të një infrastrukture të cilësisë (QI) të qëndrueshme dhe të koordinuar për të ndihmuar Shqipërinë në rrugën e saj drejt përputhshmërisë me normat evropiane dhe rritjes së konkurrencës ekonomike.

HARMONIZIMI ME STANDARDET EVROPIANE: NJË SHTYLLË PËR ZHVILLIM

Ambasadorja Huber theksoi se forumi për Infrastruktura të Cilësisë përfaqëson një hap të rëndësishëm në përparimet e përbashkëta për të përmirësuar ekonominë shqiptare, duke harmonizuar standardet kombëtare me normat evropiane. Ky proces jo vetëm që hap mundësi të reja ekonomike, por gjithashtu krijon një terren të barabartë për produktet dhe shërbimet shqiptare, duke u dhënë atyre hapësirën për të lulëzuar në tregun evropian.

BESIMI DHE TRANSPARENCA: FAKTORË THELBËSORË

Sipas znj. Huber, zhvillimi dhe mirëmbajtja e një sistemi të qëndrueshëm të infrastrukturës së cilësisë është thelbësor jo vetëm për të përmbushur kërkesat e Bashkimit Evropian, por edhe për të ndërtuar **besim dhe transparencë** midis konsumatorëve, bizneseve dhe investitorëve.

“Kjo do të sigurojë një rritje të konkurrencës, e cila, në kthim, garanton një volum të lartë tregtish dhe eksporte të qëndrueshme,” deklaroi ajo.

NJË QASJE GJITHËPËRFSHIRËSE NDAJ INFRASTRUKTURËS SË CILËSISË

Ambasadorja Huber nënvizoi nevojën për një qasje të integruar dhe gjithëpërfshirëse për të përmirësuar infrastrukturën e cilësisë në Shqipëri. Kjo përfshin:

- **Forcimin e standardeve kombëtare**, për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat ndërkombëtare.
- **Ndërtimin e kapaciteteve të organeve të akreditimit**, duke përmirësuar efikasitetin dhe cilësinë e proceseve.
- **Përmirësimin e mekanizmave të vlerësimit të konformitetit**, për të garantuar që produktet përmbushin standardet e tregut.
- **Sigurimin e gjurmueshmërisë së produkteve**, si një element kyç për të mbrojtur integritetin e zinxhirit të furnizimit dhe për të forcuar besimin e konsumatorëve.

SFIDA DHE RRUGËT PËR ZGJIDHJE

Znj. Huber preku sfidat me të cilat përballen prodhuesit dhe qeveria shqiptare:

- Për prodhuesit bujqësorë, **ruajtja e cilësisë duke rritur njëkohësisht sasinë e prodhimit** mbetet një sfidë e rëndësishme.
- Për qeverinë, sfida qëndron në ndërtimin e një infrastrukture të cilësisë ku institucionet përkatëse të jenë të mirëkoordinuara dhe të zbatojnë mekanizma të përshtatshëm në bashkëpunim me sektorin privat.

“Përparimet tona nuk janë vetëm për të përmbushur standardet, tha znj. Huber, por për të ndërtuar një Shqipëri më të qëndrueshme dhe konkurruese.”

Një Shqipëri për të Ardhmen

Ambasadorja Huber përfundoi duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit midis të gjitha palëve të interesuara, institucioneve shtetërore, sektorit privat dhe partnerëve ndërkombëtarë. Përmes një qasjeje të koordinuar dhe të qëndrueshme ndaj cilësisë dhe standardeve, Shqipëria mund të sigurojë një të ardhme ku produktet dhe shërbimet e saj të jenë të gatshme për tregjet ndërkombëtare, duke nxitur zhvillimin ekonomik, mirëqenien sociale dhe ruajtjen e mjedisit.

“Suksesi i këtij procesi, përfundoi ajo, është një sukses për të gjithë Shqipërinë.”

FIONA MCCLUNEY NË FORUMIN E 2-TË KOMBËTAR TË CILËSISË DHE STANDARDEVE: CILËSIA SI SHTYLLË E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM DHE BARAZISË SOCIALE



Në Forumin e 2-të Kombëtar të Cilësisë dhe Standardeve, **Sh.S. Fiona McCluney**, Përfaqësuese e Përherëshme e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, solli një mesazh të fortë mbi rëndësinë e cilësisë dhe standardeve si instrumente për rritje ekonomike, qëndrueshmëri mjedisore dhe drejtësi sociale.

CILËSIA DHE STANDARDET: JO THJESHT KËRKESA RREGULLATORE

Në fjalën e saj, znj. McCluney nënvizoi se cilësia dhe standardet nuk janë thjesht kërkesa rregullatore, por mjete strategjike për të nxitur praktika industriale të qëndrueshme. Ato ndihmojnë në përmirësimin e efikasitetit të burimeve, mbështesin modelet e ekonomisë rrethore dhe sigurojnë trajtim të drejtë për punëtorët përgjatë të gjithë zinxhirit të furnizimit.

“Duke promovuar përputhshmërinë me standardet e cilësisë, tha ajo, ne mund të sigurojmë që rritja ekonomike e Shqipërisë të bazohet në praktika të qëndrueshme që mbrojnë burimet natyrore dhe fuqinë punëtore.”

BARAZIA GJINORE DHE FUQIZIMI I GRAVE: NJË SHTYLLË E GQSP



Një nga elementët kryesorë të Programit Global të Cilësisë dhe Standardeve (GQSP) është përqendrimi në barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave. Znj. McCluney theksoi se përfshirja aktive e grave në zhvillimin ekonomik dhe menaxhimin e cilësisë është thelbësore për të mbyllur hendekun gjinor në biznes dhe për të nxitur rritje ekonomike më të gjerë.

“Gratë nuk janë vetëm përfituese; ato janë kontribuuese vitale për ekonominë tonë,” deklaroi ajo. “Së bashku, duhet të sigurojmë që gratë të kenë mjetet, njohuritë dhe mundësitë për të lulëzuar në tregun në ndryshim të Shqipërisë.”

DIXHITALIZIMI DHE CILËSIA: MODERNIZIMI I INFRASTRUKTURËS SË CILËSISË

Në epokën e transformimit dixhital, znj. McCluney vuri theksin në nevojën për modernizimin e infrastrukturës së cilësisë përmes integritetit të teknologjive dhe zgjidhjeve dixhitale.

“E ardhmja e sigurimit të cilësisë qëndron në përdorimin e teknologjive të reja që na ndihmojnë të ruajmë standarde të larta në një mjedis në ndryshim të shpejtë,” tha ajo. Ky transformim është thelbësor për të garantuar që NVM-të shqiptare të jenë konkurruese dhe inovative, duke përmbushur kërkesat e tregjeve lokale dhe globale.

MBROJTJA E MJEDISIT: NJË PRIORITET I DOMOSDOSHËM

Znj. McCluney theksoi rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit, duke e cilësuar atë si një përgjegjësi dhe domosdoshmëri për mirëqenien e komuniteteve dhe brezave të ardhshëm.

“Rritja ekonomike nuk duhet të vijë në kurriz të mjedisit,” theksoi ajo. “Programi GQSP njihet rolin kritik të standardeve në promovimin e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve dhe mbrojtjen e ekosistemeve.”

NJË SHQIPËRI E QËNDRUESHME DHE KONKURRUESE

Fjalimi i znj. McCluney përfundoi me një thirrje për bashkëpunim midis të gjithë aktorëve, qeverisë, sektorit privat dhe komunitetit ndërkombëtar, për të ndërtuar një Shqipëri që jo vetëm përmbush standardet ndërkombëtare, por gjithashtu udhëheq me vlera të gjithëpërfshirjes dhe qëndrueshmërisë.

“Duke ndërtuar një infrastrukturë cilësie moderne dhe gjithëpërfshirëse”, përfundoi ajo, **ne mund të sigurojmë një të ardhme ku zhvillimi ekonomik dhe mirëqenia sociale ecin dorë për dorë.**”

PËRFUNDIME DHE HAPAT E ARDHSHEM

Forumi përfundoi me angazhimin për të vijuar me përparimet të përbashkëta për forcimin e infrastrukturës së cilësisë dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm në Shqipëri. Sesionet nxorën në pah rëndësinë e përshtatjes së vazhdueshme ndaj dinamikës së tregut dhe zhvillimeve teknologjike.

Kjo iniciativë e UNIDO dhe SECO është një hap i rëndësishëm drejt ndërtimit të një të ardhme më të ndritur për Shqipërinë, një të ardhme ku cilësia dhe qëndrueshmëria janë shtyllat kryesore të suksesit kombëtar dhe ndërkombëtar.

AKTUALITET

Rama: Buxheti për bujqësinë i pesëfishuar, mbështetje për mbi 500 projekte në agroturizëm

Kryeministri Edi Rama deklaroi se përmes fondeve të qeverisë janë mbështetur mbi 500 projekte në bujqësi, kryesisht në agroturizëm, linja përpunimi dhe pika grumbullimi.

Në fjalën e tij, gjatë seancës së sotme plenare ku po diskutohet projektbuxheti për vitin 2025, Rama tha se fondet për mbështetjen e sektorit të bujqësisë janë 5-fishuar.

“Nëse ka një pikë të dytë pas asaj të pensioneve ku mençuria më e madhe e këtyre është të qepin gojën, është bujqësia pa llogaritur fare fondet europiane, thithja e të cilave ishte thuajse zero dhe me të cilat janë financuar apo janë bashkëfinancuar mbi 500 projekte kuptimplota që janë në të gjithë territorin e

Shqipërisë, gjithë ato agroturizme, gjithë ato linja përpunimi,



gjithë ato pika grumbullimi janë atje në realitetin e Shqipërisë. Unë po them këtu çfarë thotë

buxheti i 2025. 146 milion euro për bujqësinë krahasuar e dini

me sa, a e dini me sa, apo jo? Me 35 milion euro kur ishin këta, pesëfishi”, deklaroi Rama.

Rama: Deri në fund të mandatit të katërt, asnjë ndryshim në taksimin e biznesit të vogël

Kryeministri Edi Rama deklaroi se deri në fund të mandatit të katërt nuk do të ketë asnjë ndryshim në taksimin e biznesit të vogël.

140 mijë euro xhiro. Ndërkohë që deri përpara ardhjes sonë, biznesi i vogël me xhiro mbi 35 mijë euro paguante taksë 10%, ndërsa ai me xhiro mbi

gjatë seancës së sotme plenare ku po diskutohet projektbuxheti për vitin 2025.

Sipas tij, edhe pse nuk janë rritur taksat për biznesin gjatë gjithë harkut të qeverisjes së kësaj mazhorance, rritja e vazhdueshme dhe e qëndrueshme ekonomike si dhe përmirësimi i administrimit të të ardhurave të shtetit kanë mundësuar një rritje pagash shumë domethënëse.

Kryeministri vuri në dukje po ashtu se borxhi publik përgjatë dekadës së fundit është ulur me afro 15 pikë përqindje, duke e renditur Shqipërinë ndër vendet me borxhin më të ulët në rajon.

“E kemi rritur ekonominë trefish në këtë dekadë, por e kemi ulur borxhin publik me afro 15 pikë përqindje, ndër më të ulët në rajon dhe të mos harrojmë se përgjatë rrugës së vështirë për të ardhur deri këtu na u desh ta rrisnim borxhin, kur u goditëm fort dy herë, në fillim nga pandemia e pastaj edhe nga tërmeti”, u shpreh Rama.

55 mijë euro paguante taksë 10% dhe TVSH 20%. Jemi zotuar deri në fund të mandatit tonë të katërt që nuk do të ketë asnjë ndryshim në taksimin e biznesit të vogël dhe as nuk ka vitit e ardhshëm, as nuk do të ketë mandatin e ardhshëm”, u shpreh Rama në fjalën e tij,

Malaj: Buxheti për Bujqësinë nga 34 milionë euro në 2013-ën, sot 146 milionë euro

Ministri i Financave, Petrit Malaj theksoi se “në vitin 2013 investoheshin 24 milionë euro në sektorin e bujqësisë, ndërsa sot investohen 146 milionë euro. Kemi një rritje me 323%”.

Në seancën e Kuvendit ku po diskutohet projektbuxheti 2025, duke iu përgjigjur pyetjes së deputetit të opozitës, Xhelal Mziu, për TVSH për fermerët, ministri Malaj tha se “në rast se do t’i referohemi shpenzimeve totale buxhetore për sektorin e bujqësisë në raport me totalin e shpenzimeve buxhetore jemi më lart sesa vendet e rajonit, më lart se Mali i Zi dhe më lart se Bosnja-Hercegovina. Në këtë kontekst besoj që vë-

mendja e qeverisë është e plotë në këtë sektor”.

“Në lidhje me skemën e TVSH se ku duhet të aplikohet TVSH dhe ku jo, besoj se ju, deputeti Mziu, keni qenë pjesë e këtij parlamenti kur keni bërë ndryshimet përkatëse dhe kur ishte zero TVSH për fermerët dhe kur ishte 20% dhe kur u ul në 6% e kështu me radhë nëse keni një propozim konkret, i cili do të duhet të ndihmojë më mirë sektorin në fjalë mund të na i prezantoni që të bëjmë një vlerësim dhe të kemi një skemë finale që i shërben fermerëve në mënyrë më të mirë të mundshme”, theksoi Malaj.

Duke iu përgjigjur edhe

interesimit të deputetit të PD-së Andrea Mano për investimet në bujqësi, Malaj tha se “kemi një rritje të financimit të sektorit të bujqësisë me 9.9 miliardë lekë më shumë se para 10 viteve. Kemi një rritje të skemës së kompensimit të fermerëve dhe subvencionimit të naftës me 3.4 miliardë lekë, e cila në vitin 2027 do të shkojë në 5 miliardë”.

Ministri Malaj u shpreh se “po investojmë 1.9 miliardë lekë në infrastrukturën e ujëtjes e kullimit dhe kjo është e përfshirë në buxhetin 2025. Kemi gjithashtu edhe mbështetje në sektorë të tjerë sa i përket 9 nënsektorëve të bujqësisë”.

Tregtimi i vajit ekstra të virgjër në vend, kreu i shoqatës së Agrobiznesit: Nuk ka fabrika për ambalazhimin e qelqit dhe depozita inoksi për ruajtjen e vajit

Kreu i shoqatës së Agrobiznesit, Agim Rrapaj foli në ‘Sot Live në Shqipëri’ për Nertil Agalliun. Rrapaj përcolli disa nga shqetësimet që lidhen me bujqësinë dhe ushqimin në vend. Problem mbetet tregtimi i vajit ekstra të virgjër

Kreu i shoqatës së Agrobiznesit, Agim Rrapaj foli në ‘Sot Live në Shqipëri’ për

të depozituar një sasi të konsiderueshme vaji në depozita inoksi dhe ta ruajmë.”

porti me PBB edhe në raport me shpenzimet vjetore, edhe po të shikosh banka të nivelit



NGA TIRANA

RRAPAJ: MUNGESA E KONTRATAVE, SHKAK PËR IMPORTIN E VAJIT

Nertil Agalliun. Rrapaj përcolli disa nga shqetësimet që lidhen me bujqësinë dhe ushqimin në vend. Problem mbetet tregtimi i vajit ekstra të virgjër.

Për shkak se në Shqipëri nuk ka depozita inoksi ku të ruhet ky vaj, si dhe nuk ka fabrika të certifikuara shishesh qelqi, bëjnë që një pjesë e këtij vaji të ik në tregjet e huaja.

“Supermarketet kërkojnë produkte të certifikuara në shishe qelqi. Në Shqipëri nuk ka fabrikë për ambalazhimin e qelqit ka kosto të lartë. Ruajtja e vajit të ullirit, ka pak depozita inoksi. Kjo bën që në supermarkete nuk arrijmë të plotësojmë dhe bën që një pjesë e importuesve ikën në tregjet e huaja. Në shishe qelqi të përmasave të ndryshme dhe të kemi defekt në plotësimin e tregut të vendit. Më këtë periudhë kemi disa kompani importuese me kontrata me kompani të huaja. Lidhja e kontratës e kemi defekt. Nuk lidhim kontrata me afat të gjatë. Mungesa e përdorimit të kontratës arsye se kemi import të vajit të ullirit. Sezonaliteti i vajit të ullirit, nuk i kemi për

Megjithatë pavarësisht rritjes së eksportit të vajit, kur kemi ulje të prodhimit të ullirit me 3%, situata duket më mirë se më parë dhe ka vend për përmirësim.

“Historia jonë nuk vjen nga kompani prodhimi. Kemi qenë importues nga vitet ‘90 dhe kompanitë tani të fuqishme kanë qenë importuese. Janë më të fuqishme financiarisht kanë asetet të tilla që realisht që i përkushtohen më shumë garancisë sesa produkti brenda më i mirë cilësisht, dhe më i lirë. Shqetësimi juaj që importi vazhdon të jetë element dhe të krijojë problem. Kemi qenë 7 import 1 eksport, sot jemi 3 me 1. Po vjen duke u reduktuar. Do kemi shkëmbime, gjithmonë bashkëpunime. Por ne kemi rezerva për të reduktuar importin.”

Rrapaj vijon më tej duke thënë se ka nevojë për financim dhe subvencione për fermerët.

“Është domosdoshmëri fusha e financimit. Jemi në këtë fushë më të diskriminuarit me rajonin. Edhe në ra-

të dytë. Ky moment i financimit një moment që sektori i ushqimit i nënfinancuar. Subvencionet janë të nevojshme por nuk e zgjidhin problemin. Do e zgjidhin investimet, inovacioni dhe aktet ligjore. Për këto fusha punohet në front që të kompensojnë njëra tjetrën. Edhe pa subvencion ne do vazhdojmë të zvarritemi dhe jo të ecim sa ato vende.”

Së fundmi për Rrapajn shqetësim është ulja e investimeve të huaja në bujqësi, e cila meriton më shumë vëmendje në një kohë krizash.

“Që nga programi afatmesëm. Minimumet e mundshme nuk janë llogaritur. Buxheti vjetor rrjedhë e buxhetit afatmesëm. Tek ky nuk janë bërë studime për bujqësinë. Nuk është dëgjuar koncepti jonë. Po e çojnë bujqësinë në ritmin më të ulët në vitet e fundit. Investimet e huaja janë me minus 3-4% në këtë krizë ndërkombëtare për çmimet dhe kostot, klimatike, krizë kombëtare prej shpopullimit në vazhdojmë të financuajmë me të njëjtin ritëm sektorin e bujqësisë dhe ushqimit.”

Shqipëria, dy marrëveshje të reja me OBET me fokus investimet dhe tregtinë elektronike

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, përfaqësuar nga Zëvendësministria Blerta Rama, mori pjesë në takimim e 8-të Rajonal të Platformës së Tregtisë dhe Investimeve të Unionit për Mesdheun, i cili u mbajt sot në Bruksel.

Ky takimim mblodhi përfaqësues të tregtisë nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, vendet e Ballkanit Perëndimor dhe ato të Procesit të Barcelonës.

Nën drejtimin e Komisionit Evropian, në këtë takim u dis-

kutuan çështje të lidhura me tregtinë, si rregullat e origjinës preferenciale në kuadër të Konventës Rajonale PEM, të cilat Shqipëria i ka miratuar dhe tani po punon për miratimin e dispozitave tranzitore për vazhdimësinë e lehtësimit të tregtisë me partnerët tregtarë, deri në hyrjen në fuqi të rregullave të rishikuara në kuadër të Unionit për Mesdheun.

Një fokus i rëndësishëm i takimit ishin zhvillimet në kuadër të negociatave në Organizatën

Botërore të Tregtisë (OBET) për dy marrëveshje të reja, Marrëveshja për Lehtësimin e Investimeve dhe Zhvillimin dhe Marrëveshja për Tregtinë Elektronike.

Në takimim u theksua roli i këtyre marrëveshjeve në lehtësimin e tregtisë, rritjen e transparencës dhe parashikueshmërisë, krijimin e një mjedisi më të besueshëm ndërkombëtar për investimet dhe tregtinë elektronike, si dhe intensifikimin e investimeve.

INFORMACIONE

Fondi i Ambasadorëve: Afati për projektet e reja përfundon në 13 dhjetor

Ambasada Amerikane në Tiranë bëri me dije se, projekti i Fondit të Ambasadorëve për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore (AFCP) në Luginën e Drinos po ecën me hapa të shpejtë, me përpjekje të përqendruara jo vetëm në restaurimin dhe konservimin e këtyre siteve të pasura kulturore dhe historike, por gjithashtu në krijimin e shtigjeve lidhëse për kishat dhe manastiret e zonës. Projekti ka si qëllim që me përfundimin e tij, kjo zonë të tërheqë më shumë turizëm në këto site të rëndësishme.

Ambasada e SHBA gjithashtu kujtoi afatin për propozime për projektet e radhës.

“Teksa vazhdojmë të mbështesim ruajtjen e këtyre thesareve kulturore, duam t’ju kujtojmë se propozimet për raundin e ardhshëm të AFCP

duhet t’i dorëzohen Ambasadës së SHBA-së deri më 13 dhjetor 2024”, shkruhet në rrjetet



nga një deri në pesë vjet. Fondi i Ambasadorëve për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore në dy dekadat e fundit ka kontribuar me 1,5 milionë dollarë për ruajtjen e trashëgimisë kulturore në të gjithë Shqipërinë.

Grantet variojnë nga 25,000 dollarë deri në 500,000 dollarë, dhe projektet mund të zgjasin

socialë të Ambasadës së SHBA në Tiranë. Grantet variojnë nga 25,000 dollarë deri në 500,000 dollarë, dhe projektet mund të zgjasin

Malaj: Nuk ka rritje të normave tatimore deri në 2027

Ministri i Financave Petrit Malaj, deklaroi se, qeveria synon krijimin e një stabiliteti fiskal dhe deri në vitin 2027 nuk do të ketë rritje të normave tatimore.

Duke marrë fjalën në Kuvend, gjatë diskutimit të pr/buxhetit 2025, në përgjigje të pyetjes që bëri deputeti i opozitës se, pse në 2025 nuk ka një paketë fiskale, Malaj shpjegoi se, sesi e parashikon qeveria rritjen e të ardhurave pa patur një paketë fiskale.

“Është hera e parë që qeveria del pa një paketë fiskale duke krijuar një stabilitet fiskal për të gjitha shoqëritë tregtare që deri në vitin 2027 nuk do të ketë rritje të normave tatimore”, tha ai.

Ministri u shpreh se ky është një lajm shumë i mirë

për të gjithë subjektet, teksa tha se, qeveria ka projektuar realizimin e të ardhurave në disa



miliardë lekë do të merren si rezultat i rritjes ekonomike dhe 9.2 miliardë lekë do të merren si rezultat i politikave buxhetore nga rritja e pagave të kryera në vitet 2023-2024 dhe i shfaq efektet në shtator 2025.

Duhani shqiptar drejt Bosnjes - Në 10 muaj janë eksportuar rreth 140 ton

Duhani i prodhuar në Shqipëri po eksportohet kryesisht në Bosnjë dhe Hercegovinë.



Sipas të dhënave nga Instituti i Statistikave, përgjatë 10 muajve të parë të vitit, duhani që kultivohet në zonat e Shkodrës dhe Dumresë ka shkuar në

Bosnjë e Hercegovinë. Vetëm gjatë muajit të kaluar, janë eksportuar 3,000 kg

gjithashtu duhan dhe në vendet fqinje si Greqia dhe Maqedonia e Veriut përgjatë muajve të parë të vitit. Megjithatë, prodhimi i duhanit në Shqipëri ka pësuar një rënie të dukshme vit pas viti. Sipas Ministrisë së Bujqësisë, mesatarisht çdo vit prodhohen rreth 2,500 ton duhan, prej të cilëve 1,100 ton shkojnë për eksport. Deri më tani, sipas shifrave të Instat, Shqipëria ka eksportuar rreth 140 ton cigare në vende të tjera. Ky eksport, megjithatë, është shumë më i ulët se sa pritej në vitet e kaluara. Pjesa tjetër e prodhimit, rreth 1,400 ton duhan, konsumohet brenda vendit, shpesh në mënyrë informale, ku duhani shitet në formate të paketimeve të madh dhe më shpesh në forma të paketuara jo formale.

Dredha pret në takim ambasadorën e Kinës, në fokus zhvillimi i turizmit

Ambasadorja e Republikës së Kinës, Pang Chunxue vizitoi për herë të parë qytetin e Vlorës, ku u prit në takim nga kryebashkiaku Ermal Dredha.

Gjatë takimit Chunxue dhe Dredha folën për mundësitë e mëdha për të zhvilluar turizmin, në të gjitha përmasat, jo vetëm gjatë sezonit veror.

“Bashkëpunimet e herëpashershme nuk do t’i shërbejnë vetëm investimeve, por edhe ndërveprimeve kulturore që shoqërojnë gjithmonë këto bashkëpunime”, tha Dredha.

Pas takimit, Dredha dhe ambasadorja Chunxue vizituan qytetin e Vlorës.



Investitorët austriakë, interes për të zgjeruar praninë në tregun shqiptar

Investitorët austriakë shfaqin interes për të zgjeruar praninë në tregun shqiptar.

Një grup investitorësh austriakë si dhe përfaqësues të ambasadës së Austrisë në vendin tonë, u pritën në Tiranë nga drejtues të Agjencisë Kombëtare të Zhvillimit të Investimeve, Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, si dhe Tatimeve.

Drejtoresha Ekzekutive e AIDA-s, Laura Saro gjatë takimit theksoi gatishmërinë e AIDA-s për të realizuar projekt propozimet.

Gjithashtu, Saro prezantoi projektet e fundit në bashkëpunim me ministritë dhe investitorë potencialë, duke i ofruar mbështetje për zgjidhjen e problematikave të bizneseve austriake që operojnë në Shqipëri.

Ambasadorja e Austrisë në Tiranë, Monika Zach theksoi se marrëdhëniet tregtare mes Shqipërisë dhe Austrisë kanë pësuar një përmirësim të ndjeshëm.

Por megjithatë, Zach shtoi

se ka hapësire që dy vendet të forcojnë më tej marrëdhëniet në disa sektorë me potencial të lartë zhvillimi.

Shkëmbimet tregtare të Shqipërisë me Austrinë llogariten 7.8 miliardë lekë gjatë periudhës janar-shtator të këtij viti.

dhe ai i sigurimeve dominohen aktualisht nga biznese austriake. Në Shqipëri operojnë gjithsej 100 ndërmarrje me kapital austriak (përfshirë edhe ndërmarrjet me kapital të përbashkët).

Gjithashtu edhe në fushën



Marrëdhëniet ekonomike ndërmjet Shqipërisë dhe Austrisë janë intensifikuar dukshëm gjatë viteve të fundit.

Veçanërisht sistemi bankar

e turizmit ka një potencial të madh zhvillimi. Numri i turistëve austriakë që vizitojnë çdo vit Shqipërinë po rritet gjithmonë e më shumë.

Shpërblimi i pensionistëve, vendimi botohet në Fletoren Zyrtare - Ja deri kur mund të tërhiqet

Në Fletoren Zyrtare është publikuar vendimi për shpërblimin e pensionistëve për festat e fundvitit. Sipas këtij vendimi, shpërblimet kalohen në llogaritë e pensionistëve në muajin dhjetor 2024 dhe paguhen gjatë këtij muaji. Në rastet kur pagesat efektive nuk kryhen brenda muajit dhjetor 2024, ato paguhen deri në datën 30 qershor 2025. Shpërblimet e patërhequra parashkruhen pas datës 30 qershor 2025.

Zbatimi i këtij vendimi do të kërkojë 10 miliardë lekë, ku 9 miliardë e 805 milionë do të jetë shpërblimi dhe 68 milionë e 637 mijë lekë do të jenë shpenzime administrative për dhënie dhe shpërblimit. Rreth 3.6 miliardë lekë do të përballohen prej fondit të kontigjencës për bonusin e pensionistëve, 2.4 miliardë të tjera do të merren gjithashtu nga arka e

Sigurimeve Shoqërore, nga fondi për indeksimin e pensioneve dhe 3.7 miliardë lekë do të derdhë vetë qeveria nga buxheti i planifikuar për sigurimet shoqërore për vitin 2024.

Rikujtojmë se këtë vit, bonusi do të jetë më i madhi ndonjëherë për 724 mijë e 933 pensionistë, nga të cilët 511 mijë e 173 pensionistë me pension deri në 20 mijë lekë do të marrin 150 euro

ose 15 000 lekë, 213 mijë 760 pensionistë që janë me pensione më mbi 20 mijë lekë përfitojnë 100 euro ose 10 000 lekë. Gjithashtu, 65 763 pensionistë invalidë, 44 561 mijë pensione familjare, gra e burra të ve, fëmijë jetim, do të kenë bonus të plotë 15 000 lekë.

Tërheqja e parave do të mund të bëhet pranë çdo pikë postare ose në bankat e nivelit të dytë.



SIGURI USHQIMORE

Duka: Fermerët të subvencionohen për primet për sigurimin e produkteve bujqësore

Komisioni për Veprimtari-në Prodhuese miratoi nën për ne projektbuxhetin për vitin 2025, i cili në parim u miratua të martën në Kuvend, ndërsa pritet që të kalojë në seancë plenare për miratim nën për nen, më 3 dhjetor.

Deputetë të komisionit paraqitën disa propozime për ndryshime, të cilat do t'i kalojnë për miratim Komisionit të Ekonomisë dhe Financave si komision përgjegjës.

Relatori i projektbuxhetit, Laert Duraj kërkoi rialokim të fondeve të transfertës së pakushtëzuar drejt bashkive Elbasan dhe Gjirokastrë në zërin “menaxhim i mbetjeve”, pasi sipas tij, këto dy qytete po përballen me numër të lartë turistësh në vitet e fundit.

Deputeti i Partisë Demokratike, Luan Baçi kërkoi që fondi prej 1.3 miliard lekësh i planifikuar për kontratat koncesionare të cilat, sipas tij, prej vitësh financohen nga buxheti i shtetit dhe kanë rezultuar me shkelje ligjore dhe një pjesë e tyre janë

edhe në hetim nga SPAK, të pezullohen dhe të shkojnë për mbështetjen e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike.

“Është fakt që inceneratori i

familjeve shqiptare që trajtohen nga skema sociale e ndihmës ekonomike”, tha ai.

Ndërsa kreu i Partisë Agrare Ambientaliste, Agron Duka



Tiranës nuk ekziston. Me qëllim ndalimin e shpërdorimit dhe vjedhjes së parave publike propozoj të pezullohen pagesat buxhetore për këtë kontratë koncesionare. Fondi i planifikuar për 2025 prej 1.3 miliard lekë të kalojë për të rritur ndihmën ekonomike të 62 mijë

kërkoj shtim të fondeve të subvencioneve direkte në bujqësi, duke e rritur shumën nga 44 milionë lekë në 100 milionë lekë. Po ashtu, ai kërkoi mbështetjen e fermerëve për të siguruar produktet e fermave.

“Fermerët duhet të subvencionohen për primet”, tha ai.

Rreziqet nga klima, duhen 6 mld USD investime - BB: Mbrojnë jetën dhe garantojnë rritjen ekonomike, Shqipëria është tejet e riskuar

Shqipëria duhet të investojë 6 miliardë dollarë gjatë dekadës së ardhshme për të mbrojtur në mënyrë sa më efektive qytetarët dhe pronat nga rreziku në rritje i përballjes me fenomene ekstreme që vijnë nga ndryshimet klimatike”.

Sipas Raportit të Grupit të Bankës Botërore për Klimën dhe Zhvillimin për Shqipërinë, që sapo është publikuar ne jemi një nga vendet më të rrezikuara nga katastrofat natyrore në Evropë, sikurse janë përmbytyet, zjarret në pyje dhe rrëshqitjet e dheut.

Ndërkohë që, sipas vlerësimeve konservative, në mungesë të masave proaktive, dëmet ekonomike të lidhura me klimën mund të arrijnë në 7% të PBB-së së Shqipërisë.

Gjithashtu, raporti thekson se investimet për përshtatjen klimatike nuk janë vetëm të domosdoshme, por mund të kontribuojnë edhe në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik.

Studimet nga vende të ngjashme me Shqipërinë flasin se për çdo 1 euro të investuar në përpjekjet për përshtatjen klimatike, kthimi i investimit mund të arrijë deri në 10 euro, ku përfshihen humbjet më të pakta, mundësitë ekonomike dhe përfitimet sociale e mjedisore më të mëdha.

“Veprimet për ndryshimet klimatike çojnë drejt rritjes ekonomike të qëndrueshme dhe të ardhmes më rezistente ndaj tyre. Ndërtimi i kësaj rezistence krijon mundësi më të mëdha për bizneset dhe njerëzit, nxit krijimin e vendeve

të punës dhe mbështet rritje ekonomike afatgjatë.” - tha Emanuel Salinas, Menaxher i Zyrës së Bankës Botërore për Shqipërinë.

Raporti përshkruan edhe një udhërrëfyes të masave të nevojshme për kalimin e Shqipërisë drejt një modeli rritjeje të qëndrueshme dhe rezistente ndaj klimës.

Kjo përfshin nevojën për investime të menjëhershme për zbutjen e ndikimit të katastrofave, zhvendosjen drejt energjisë së rinovueshme për dekarbonizimin afatgjatë, reformat në financat publike për të mbështetur nismat për klimën dhe nxitur investimet private, si dhe përmirësimin e kuadrit rregullator për të inkurajuar efikasitetin dhe inovacionin.

Patatja shqiptare nuk “kalon kufirin”! - Shkak, një bakter. Denaj: Presim zhbllokim të eksporteve në 2025-ën

Prej disa vitësh prodhuesit shqiptarë nuk arrijnë të deportojnë në tregjet ndërkombëtare me produktin e patates. Shkak për këtë është një bakter që disa që ka patatja dhe toka ku prodhohet, duke bërë që BE të ndalojë eksportin e kësaj kulture bujqësore.

“Kemi nevojë të rrisim eksportet për patatën, kam pasur një komunikim me DigiSante

në Bruksel sepse jemi të bllokuar për eksportin e patates për shkak të një bakterit dhe ne kemi bërë dy vjet analizat dhe ky bakter nuk është më. Dhe në 2025 presim që nëse dalim pa mbetje dhe të mund të eksportojmë”.

Referuar të dhënave të Institutit të Statistikave, në vitin 2022, prodhimi i patates u rrit me 1,5%, duke arritur në rreth 263 mijë tonë. Ndërsa sipër-

faqja e kultivuar rezultoi në afro 10.068 hektarë.

Ndër qarqet që kultivojnë më shumë janë Korça, Elbasani, Shkodra dhe Fieri. Por pavarësisht se nuk eksportojmë, importi i këtij produkti në vend është mesatarisht në 5 mijë ton në vit.

Importin e patates e dominojnë shtete si Kosova, Holanda, Greqia, Egjipti, Gjermania dhe Franca.

Rast i murtajës afrikane të derrave në Shqipëri, MBZHR merr masa të menjëhershme

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural informon se kampionet e dërguara nga kadavra të derrave të egër dhe të kryqëzuar, prej Shërbimit Veterinar Rajonal të Qarkut Lezhë, në Laboratorin e Referencës – Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, sot në datën 26.11.2024, kanë rezultuar pozitive me testin konfirmator RT – PCR, për praninë e sëmundjes së Murtajës Afrikane të Derrave.

Në një njoftim për shtyp, MBZHR thekson se, në vijim të rastit Alert, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka marrë menjëherë masat për hyrjen në fuqi të Urdhrit të Ministrit “Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së Murtajës Afrikane të Derrave” dhe ngritjen e Qendrës Kombëtare të Krizës.

Sipas MBZHR-së Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve kanë nisur marrjen e masave për: Përcaktimin e zonës mbrojtëse me rreze 3 kilometra dhe zona e mbikëqyrjes me rreze 10 kilometra rreth fshatit Mali i Rencit, Njësia Administrative Shëngjin, në koordinatat me gjatësi 41.82835 dhe gjerësi 19.57711, në të cilën janë konstatuar derrat e ngordhur, të konfirmuar për praninë e Murtajës Afrikane të Derrave, me testin e RT – PCR.

Regjistrimin e pronarëve të derrave dhe regjistrimin e përgjithshëm të popullatës së derrave në zonat 3 dhe 10 kilometra rreth fshatit Mali i Rencit, Njësia Administrative Shëngjin.

Murtaja afrikane e derrave në Lezhë, Autoriteti i Veterinarisë: Pesë grupe në terren, situata nën monitorim

Pas konfirmimit të Murtajës Afrikane të Derrave, në Malin e Rencit në datën 26 nëntor, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve

Mbarështimin e të gjithë derrave dhe mbajtjen e ushqimit të tyre në zonat e mbrojtjes dhe mbikëqyrjes në mjedise të mbyllura.

Ekzaminimin e përditshëm klinik të derrave në këto zona dhe të gjitha fermave indus-



triale të derrave dhe rezultatet duhet të mbahen në protokolle.

Ndalimin e lëvizjes për çdo derr të gjallë, mishit të freskët të derrave dhe produkteve të mishit të derrave që vijnë nga zonat mbrojtëse dhe të mbikëqyrura.

Marrjen e kampioneve për testim laboratorik për Murtajën Afrikane të Derrave nga të gjithë derrat shtëpiakë dhe të egër që zbulohen të ngordhur, në këto dy zona.

Identifikimin e fermave industriale të derrave, në zonat e mbrojtjes dhe mbikëqyrjes dhe zbatimin nga fermerët të masave të biosigurisë në fermat e derrave.

Ndalimin e tregut të derrave në zonat perimetrale 3 dhe 10 kilometra, rreth fshatit Mali i

Rencit, Njësia Administrative Shëngjin.

Dezinfektimin e mjeteve që hyjnë ose dalin në zonat mbrojtëse dhe të mbikëqyrjes vendosjen e sinjalistikës e posterave informues në hyrjet e fermave të prekura dhe qen-

drat e komunave.

MBZHR i bën thirrje pronarëve të kafshëve të zbatojnë masat karantinore dhe të biosigurisë, veterinerëve privatë, teknikëve veterinarë, drejtuesve të njësive të qeverisjes vendore, punonjësve e shërbimit pyjor dhe gjuetarëve, që në rast dyshimi apo prani të shenjave klinike në derra të informojnë menjëherë Shërbimin Veterinar Rajonal në numrin e gjelbër 08003366 ose në rrugë zyrtare në adresën e e-mail-it: info@akvmb.gov.al.

MBZHR njofton qytetarët se Murtaja Afrikane e Derrave nuk është një sëmundje që prek njeriun, mirëpo ajo përbën një rëndësi të madhe për ekonominë dhe shëndetin e popullatës së derrat, në vendin tonë.

të tjerë të ngordhur prej disa ditësh, të cilët janë djegur dhe gërosur, ndërsa zona është dezinfektuar.

Autoriteti Kombëtar i



ka vijuar monitorimin e zonave perimetrale 3 dhe 10 km nga vatra e konfirmuar me Murtajën Afrikane të Derrave.

Në datë 27 nëntor, në Malin e Rencit janë gjetur 200 metra nga vatra parë edhe 9 derra

Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve njofton se janë shpërndarë 200 postera informues e ndërgjegjësues në zonat e mbrojtjes dhe atë të mbikëqyrjes.

Po kështu, gjatë monitorim-

it dhe inventarizimit rigoroz të gjendjes së kafshëve të llojit derr, janë identifikuar e matriculluar edhe 64 derra të butë.

Shërbimi Veterinar Rajonal ka dërguar për çdo ditë pesë grupe verifikimi dhe kontrolli për marrjen e masave për parandalimin e përhapjes së sëmundjes.

Gjatë monitorimit të datës 28 nëntor, nuk janë evidentuar raste të reja dhe as shenja klinike gjatë monitorimit klinik të kafshëve në zonat e kontrolluara.

Murtaja Afrikane e Derrave (MAD) është sëmundje ngjitëse virale që shkakton ethe hemorragjike tek derrat e butë dhe derrat egër. Sipas gjetjeve shkencore të deritanishme kjo sëmundje nuk transmetohet tek njeriu (nuk i prek njerëzit).

Megjithatë AKVMB apelon të gjithë fermerët që të raportojnë për çfarëdo shenje klinike të sëmundjes.



SHOQATAT ANËTARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA

LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



KREDI E SHPEJTË MIKRO PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

KREDI MIKRO

deri në **2,500,000** LEKË



FED
invest 

**GJITHMONË
FINANCË SOCIALE**

HISTORI

Kontributi i fshatarësisë shqiptare në mbrojtjen e atdheut, në pesë vitet e Luftës së Dytë Botërore

(Me rastin e 80-vjetorit të Çlirimit të Atdheut, 7 Prill 1939 - 29 Nëntor, 1944)

Prof. Ass. Enver Isufi, Agronom në Mbrojtjen e Bimëve dhe Bujqësinë Biologjike



Prof. Ass. Enver Isufi, Agronom në Mbrojtjen e Bimëve dhe Bujqësinë Biologjike

Fshatarësia, e cila gjithë jetën është marrë dhe merret me bujqësi dhe blegtori, nuk ka qenë dhe nuk është vetëm burimi i ushqimit të popullit, por ka qenë dhe është forca kryesore fizike dhe mendore për mbrojtjen e atdheut nga luftat pushtuese të shkaktuara nga vendet fqinjë dhe jashtë rajonit të Ballkanit. Shqipëria as me ushtri, as me grupime të vogla, as me grupe terroriste, as me kriminelë të instruktuar, historikisht nuk ka sulmuar ndonjëherë vendet fqinjë dhe ato më të largëta.

E kundërta ka ndodhur, Shqipërinë e kanë sulmuar shumë vende, disa ushtarakisht, disa me grupe terroriste, disa me sulme ekonomike me atë që sot quhet "embargo ekonomike", ose siç thirret "sanksione ekonomike". Ndërkohë Shqipëria edhe në sistemin socialist, nuk i shqetësoi fqinjët dhe më larg tyre, as me ndonjë kriminel, as me një thes drogë, as me një prostitutë, as me kontrabandë armësh. Ne u kemi shitur mallra bujqësore si fruta, perime, bimë mjekësore, vaj ulliri, lëndë të para si krom e naftë, bakër e hekur nikel, etj.

Ky është shkaku që sot Shqipërinë e respekton gati e gjithë bota, sepse nuk i ka borxh historik moral dhe material asnjë shteti. Kjo sjellje e shqiptarëve e ka bërë Shqipërinë e sotme më të besueshme për paqen, të paktën në rajonin e Ballkanit.

Për gjeneratat e reja dhe për ata që nuk kanë lexuar mjaftueshëm mbi heroizmat e Luftës së Dytë Botërore, për të kuptuar rolin e fshatarësisë në këtë luftë të madhe, duhet të rikujtojmë disa elementë:

- Fshatarësia në kohën e luftës së dytë botërore ishte forca dominuese e popullsisë së vendit.
- Duhet përmendur organizimi kapilar i reparteve partizane, që nga njësitë më të vogla, si njësitet guerile, çetat partizane, batalionet, brigadat e deri te korpuset ushtarake.

Pa pjesmarrjen e fshatarësisë, këto struktura kapilare ushtarake nuk do të mund të ngriheshin dhe të funksiononin.

Edhe sot është shumë mbresëlënëse, sesi u mundësua një organizim i tillë në ato kushte të vështira të logjistikës, të komunikimit, të shkollimit.

Roli i fshatarësisë shqiptare në mbrojtjen e atdheut, gjatë LANÇ (7 Prill, 1939 - 29 Nëntor, 1944) ishte i pazëvendësueshëm për disa faktorë objektivë dhe subjektivë, të cilët po i rreshtojmë më poshtë:

Çfarë epërsish objektive kishte fshatarësia në këtë luftë legjendare?

- Territori i gjerë gjeografik i fshatarësisë jep mundësi manovrimi për mbrojtje dhe sulme ushtarake.
- Terreni i thyer me plot kodra, male, lugina, përrejt,

lumej, shpella e gropa, pyje, janë rrethana ndihmuese për të zhvilluar teatrin e luftës dhe janë gracka për të rënë brenda ushtrisë armike.

- Njohja në detaje e territorit nga popullsia vendëse, menaxhoi shumë më mirë veprimet luftarake.

- Familjet fshatare të shumta në numër, kanë qenë strehë për luftëtarët e Luftës Partizane.

- Familjet fshatare kanë qenë burim ushqimi për luftëtarët.

- Familjet fshatare me kafshët e ngarkesës kanë qenë pjesë e logjistikës së lëvizjeve të forcave partizane dhe bazës materiale luftarake.

- Pasuri tjetër luftarake ishte përvoja shekullore. Fshatarësia ka trashëguar përvojë shekullore në luftat për liri. Lufta për mbrojtjen Shkodrës nga serbët dhe malazetët në vitet 1911- 1913 dhe lufta për mbrojtjen e Vlorës nga pushtimi italian në vitin 1920, ishin dy luftat më të fundit që kishin lënë trashëgimi patriotike dhe mbajtën gjallë patriotizmin shqiptar.

Njësitë partizane shkelën të gjithë territorin e Shqipërisë. Nuk dihen sa mijra kilometra ka përshkuar kryq e tërthor hartës së Shqipërisë dhe jashtë saj një partizan, një komandant, një komisar, një korrier, një kalë ngarkese, ose mjet tjetër lëvizës etj.

- Roli vendimtar i fshatarësisë shqiptare argumentohet me faktin se njësitë më të fuqishme partizane siç ishin Brigadat Sulmuese u krijuan të gjitha nëpër fshatra. Ky fakt pasqyrohet edhe tabelën e mëposhtme.

| BRIGADAT SULMUESE PARTIZANE | DATA DHE VENDI I THEMELIMIT BRIGADAVE |
|-----------------------------|--|
| BRIGADA 1-parë SULMUESE | Gusht, 1943, Vithkuq, Korçë |
| BRIGADA 2-të SULMUESE | 28 Nëntor, 1943, Shëngjergj, Tiranë |
| BRIGADA 3-të SULMUESE | 9 Tetor, 1943, Arbanë, Tiranë |
| BRIGADA 4-të SULMUESE | 28 Dhjetor, 1944, Voskopojë, Korçë |
| BRIGADA 5-të SULMUESE | 28 Nëntor, 1943, Gumenicë, Vlorë |
| BRIGADA 6-të SULMUESE | 7 Gusht, 1943, Kardhiq, Gjirokastrë |
| BRIGADA 7-të SULMUESE | 12 Mars, 1944, Vlsh/Skrapar |
| BRIGADA 8-të SULMUESE | 12 Mars, 1944, Zagori, GJIROKASTER |
| BRIGADA 9-të SULMUESE | 16 Tetor, 1944, Lozhan/ Gorë/ KORÇË |
| BRIGADA 10-të SULMUESE | 29 Tetor, 1944, Sulaj/ Karbunarë/ LUSHNJË |
| BRIGADA 11-të SULMUESE | 1 Nëntor, 1944 fshatrat e Fierit |
| BRIGADA 12-të SULMUESE | 20 Maj 1944, Suke/PËRMET |
| BRIGADA 14-të SULMUESE | 17 Gusht, 1944, Sheper, Zagori/GJIROKASTER |
| BRIGADA 15-të SULMUESE | 27 Qershor, 1944, Protopapë, KORÇË |
| BRIGADA 16-të SULMUESE | 20 Gusht, 1944, Therapel/SKRAPAR |
| BRIGADA 17-të SULMUESE | 29 Shtator, 1944, Cjinar/ELBASAN |
| BRIGADA 18-të SULMUESE | 18 Gusht 1944, Sllatinë/DIBËR |
| BRIGADA 19-të SULMUESE | 30 Gusht, 1944, Cerkovicë/FIER |
| BRIGADA 20-të SULMUESE | 20 Shtator, 1944, Protopapë/KORÇË |
| BRIGADA 21-të SULMUESE | 21 Shtator, 1944, Zallmner |
| BRIGADA 22-të SULMUESE | 18 Shtator, 1944, Pezë/TIRANË |
| BRIGADA 23-të SULMUESE | 9 Shtator, 1944, Zall-Mner/KRUJË |
| BRIGADA 24-të SULMUESE | 4 Tetor, Bicaj/KUKËS |
| BRIGADA 25-të SULMUESE | 6 Nëntor 1944, Astë/TROPOJË |

Ushtria partizane përveç armikut, pati pengesa serioze edhe nga grupimet politike shqiptare të mashtruar nga pushtuesit, të cilët nxitën në Shqipëri ndjenjat e nacionalizmit fallco, ashtu si edhe në vendet që ata pushtuan. Kjo propagandë nacionaliste se gjoja pas fitores së fashizmit italian dhe nazizmit gjerman, Shqipëria do të merrte pjesët e humbura si Kosovën dhe Çamërinë, propagandë nacionaliste e cila pati deri diku sukses, sepse paralizuan shtresa të popullsisë shqiptare për t'u bashkuar me Frontin Antifashist. Në fakt dokumentat e gjetura më vonë

vërtetojnë se qëllimi i Italisë dhe Gjermanisë ishte ndarja e Shqipërisë sipas intereseve të tyre, por edhe të fqinjëve tanë veriore dhe jugorë, Serbia dhe Greqia.

Natyrisht udhëheqësit e këtyre grupimeve politike (Balli Kombëtar dhe Legaliteti), në thelb nuk është se ishin kundra Shqipërisë, por për të kënaqur egot e tyre karrieriste që kishin ushqyer edhe para luftës, bënë lojë të dyfishtë, mes pushtuesit dhe forcave aleate antiitaliane dhe antigjermane. Këto aleatë ishin Amerika, Anglia, Bashkimi Sovjetik. Kjo lojë e dyfishtë po rrezikonte fitoren dhe forcat aleate megjithë këshillimet e tyre që grupimet shqiptare nacionaliste të mos i dëgjonin fuqitë pushtuese, nuk po mund t'i bindnin dot forcat nacionaliste shqiptare që ato të bashkoheshin me partizanët.

Kur bashkëpunimi i tyre me pushtuesit Italianë dhe gjermanë u pa më qartë, aleantët mbështetën plotësisht ushtrinë partizane, e cila ishte më e qartë, më e sinqertë, më e organizuar. Kjo ndodhte kështu edhe për faktin se ushtria partizane dhe udhëheqja e luftës, kishte këshilltarë të huaj dhe vendas, të qartë për strategjinë dhe taktikat që përdorte fashizmi dhe nazizmi. Fshatarësia shqiptare e kuptoi që këto këshilla të aleatëve ishin në mbështetje të lirisë së Shqipërisë dhe u bashkuan masivisht me forcat partrizane. Një pjesë e vogël e fshatarësisë edhe u çorientuan nga kjo propagandë e nacionalizmit fallco. Më thjeshtë akoma, nuk ka sesi të mbështesësh një forcë ushtarake që i kishte shpallur luftë të gjithë Europës. Nuk ka sesi t'i besosh këtyre vendeve pushtuese, se nesër këta do mendonin për interesat e trojeve të Shqipërisë, kur nisën një luftë për të rrëmbyer të gjithë Europën.

Në fakt edhe forcat aleate patën ndikimet e tyre negative në çorientimin e nacionalistëve shqiptarë. Meqenëse drejtuesit e Ballit Kombëtar dhe Legalitetit shumica kishin prirje perëndimore edhe aleatët bënë shpesh lojë të dyfishtë. Meqenëse ata dëshironin pas luftës të bashkëpunonin me forcat nacionaliste, aleatët këshilltarë në vendin tonë, ditën këshilloheshin me drejtuesit e luftës partizane dhe natën ndryshe këshillonin forcat nacionaliste. Me fjalorin e sotëm aleatët donin t'ua jepnin nacionalistëve fitoren "mbi tavolinë". Këtë e bënë se kishin frikë se fitorja e partizanëve do ta afronin Shqipërinë me komunizmin. Kjo lojë e dyfishtë e aleatëve rriti mosbesimin e udhëheqësve të luftës partizane, mosbesim që pati kosto edhe në kalimin tonë në komunizëm. Në këtë kalim në komunizëm edhe aleatët patën rolin e tyre. Lobingjet e ndryshme e dinin se me kalimin i Shqipërisë në shtet demokratik, do dilte shumë shpejt para fuqive të mëdha, kërkesa jonë për ta kërkuar Kosovën dhe Çamërinë. Duke e shtyrë Shqipërinë drejt komunizmit e kishin më të lehtë ta sulmonin dhe ta dobsonin Shqipërinë, që ajo të mos kishte forcën e duhur të zgjeronte trojet e saja, ashtu siç i kishte pasur dikur. Disa shtete të mëdha shprehën propozime që Greqia të merrte atë që ajo e quante Vorio-Epir. Në këto kushte qefmbetja e Shqipërisë ndaj disa forcave aleate, pati një bazë, e cila e shtoi më tepër forcën për ta shtyrë Shqipërinë drejt komunizmit, e cila kërkoi mbështetje te Bashkimi Sovjetik socialist dhe komunist. Pra atmosfera pas luftës u krijua e tillë që Shqipëria të anonte në sistemin komunist. Direkt pas luftës shteti shqiptar u njoh me vështirësi nga forcat aleate, ndonëse ishte vendi i parë në Europë që u përball me sulmin fashist. Shqipëria krijoi çetën e parë antifashiste në Europë, e

HISTORI

Kontributi i fshatarësisë shqiptare në mbrojtjen e atdheut, në pesë vitet e Luftës së Dytë Botërore

(Vijon nga faqja 10)

cila ishte Çeta e Pezës.

Kështu ndodhi edhe në kohën e Skënderbeut. Skënderbeu ishte Europeanisti më i madh i kohës, por Shqipërinë në shekuj e lanë vetëm. Kishin frikë dhe kanë edhe sot frikë nga historia e lashtë e trojeve dhe gjuhës sonë pellazge, ilire, shqiptare. Kaq e thjeshtë është historia. Të tjerat janë detaje, njerëz e ngjarje, gabime me të drejtë dhe me të pa drejtë, siç ndodh në çdo luftë botërore.

Kështu që nacionalistët shqiptarë, përfshirë edhe fshatarësinë, patën dy llojë çorientimesh: nga forcat pushtuese dhe nga shkelja e syrit nga aleatët.

Për fuqitë aleatë, më e rëndësishme ishte mundja e fashizmit që kërcënonte paqën botërore, se sa cila forcë politike do të udhëhiqte Shqipërinë pas luftës, prandaj mbështetën me të gjitha forcat ushtrinë çlirimtare partizane, drejtuar nga udhëheqësit komunistë.

Në këto kushte Çurcilli (Winston Churchill), kryeministri i Anglisë gjatë kësaj këtë lufte, shprehu para botës qëndrimin e fuqive aleate: **“Kjo është një luftë për jetë a vdekje me fuqitë e Boshtit. Kush rreshtohet me ne në këtë luftë, është aleati ynë. Kush rreshtohet me armikun, është armiku ynë”.**

Boshti i cili futi botën në luftë quhej aleanca mes Italisë, Gjermanisë dhe Japonisë. Italianët këtë Bosht e thirrnin ROBERTO (Romë-Berlin-Tokio).

Edhe pas 80 vitesh, fshatarësia shqiptare është në kahun e drejtë të historisë. Flamuri shqiptar valëvitet sot me flamujt e aleatëve SHBA-së, Anglisë dhe të BE-së, vende anëtarë të NATO-s. Fshatarësia shqiptare është më pranë se kurrë të futet zyrtarisht dhe me të drejta të plota me vendet e tjera **Europiane**.

Në këtë bum turistik që po përjeton Shqipëria sot, është fshatarësia jonë ajo që po ushqen popullin e saj dhe miliona miq të cilët vijnë si turistë në Shqipëri.

USHTRIA
Viti i 74-të i botimit Nr. 17 (827715) Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes E premte, 23 Prill 2021

Ambasadorja e SHBA-së, Yuri Kim
Kushdo që sheh hartën do kuptojë rëndësinë gjeostrategjike të Shqipërisë...
13 prill 2021. Pas një mbledhjeje të kësaj natyres "Defender Europe 21".

Kampionati i Shahut në strukturat e Forcave të Armatosura
NGA DATA 12 DERI ME 16 PRILL 2021

Gjeneral gjeneralmajor Bajram Begaj, intervistë për "Zëri i Amerikës" Shqipëria mikpritëse e stërvitjes "Defender Europe 21" më e madhja e NATO-s në rajon
Shtetet e Bashkuara shprehin vendosmërinë, aftësinë, sigurinë dhe që janë garant i sigurisë dhe mbrojtjes së Europës Qendrore, Veriore dhe për rajonin tonë delikat të Ballkanit Perëndimor

Projektet e SHBA-së për FARSH
Modernizimi i Forcës Ajrore me helikopterët Black Hawk

Stërvitja
Forca Tokësore mban peshën kryesore në stërvitjen "Defender Europe - 21"

Rustem Peçi "komandanti legjendar" që edukoi studentët ushtarakë
Njëzet nga jeta në mesin 80-vjeçar

KURSI I STËRVITJES INDIVIDUALE
Shtetas radhë: Certifikohen 141 rekrutët të riëj për Forcat tona të Armatosura

OPINJONET KANDIDATË PËR STUDIUM
Pesë (5) kandidatë për studime në shkollat e larta ushtarake të Greqisë

<http://www.mod.gov.al/index.php/publikime/gazeta-ushtria>
e-mail: gazetaushtria@mod.gov.al

"DEFENDER, 21"
LOJA E MADHE STËRVITORE E USHTRISË SHQIPTARE ME USHTRITË E VENDEVE ANËTARE NATO-S, viti 2021



Foto 7 prill 1939

Bashkia e Durrësit e ndërtuar nga italianët në vitin 1929. Pas dhjetë viteve (7 prill, 1939), shikoni pranë kësaj Bashkie tanket e pushtimit Italian. Pra investimet italiane ishin jo për parneritet, por për kolonializim dhe vasalitet.



Ndërtesa me tre flamujt e shteteve pushtuese të Boshtit, ku bëheshin kordinimet për pushtimin e Europës.

Përulja me respekt ndaj dëshmorëve të lirisë, nga qyteti dhe nga fshati, do vazhdojë në shekuj.



TEKNOLOGJI

Zhvillohet workshop-i “Bujqësia e zgjuar në Shqipëri, arritje dhe sfida për të ardhmen”

Në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u zhvillua workshop-i “Bujqësia e zgjuar/ Smart Agriculture në Shqipëri; arritjet dhe sfidat për të ardhmen” në bashkëpunim me Universitetin Bujqësor të Tiranës, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Këshillin e Agrobiznesit Shqiptar.

Kjo veprimtari u përgatiti dhe u zhvillua nën kujdesin e një komiteti nderi të kryesuar nga akad. Skënder Gjinushi, kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, dhe me organizimin e një komiteti shkencor të drejtuar nga akad. asoc. dr. Fatbardh Sallaku.

Workshop-i u çel nga prof. dr. Vjollca Ibro, anëtare e Komisionit të biologjisë bu-

zëndëskryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Në emër të Kryesisë së kësaj akademie, akad. Toke përshëndeti organizatorët e forumit e në mënyrë të veçantë akad. Fatbardh Sallakun dhe prof. dr. Vjollca Ibron, si dhe bashkëpunëtorët e tjerë, të cilët bashkuan studiuesit dhe specialistët më në zë të tokës dhe të teknologjisë bujqësore e bizneseve private që veprojnë në fushën e IT, e cila po gjen aplikim çdo ditë e më shumë në Shqipëri.

Akad. Toke theksoi se Aka-

do të orientojë të rinjtë drejt studimeve në fusha të tilla prioritare si bujqësia, inxhinieria e pyjeve, etj.

Znj. Anila Denaj, Ministre e

çështje që kanë të bëjnë me kërkimin dhe inovacionin në bujqësi dhe sugjeroi që gjetjet e këtij workshop-i të bëhen të njohura për të gjithë aktorët.

12 këshilla rajonale të agrobiznesit që operojnë në sek-

të Tiranës dhe Kryesinë e ASHSH-së për hapjen e dyerve të këtij institucioni që është simbol i shkencës shqiptare ndaj veprimtarive të përbashkëta shkencore, të lidhura ngushtë me çështje të rëndësishme të bujqësisë e agrobiznesit, duke



jqësisë dhe veterinarisë. Ajo vuri në dukje se bujqësia si një shkencë jetësore e lidhur me ushqimin e popullsisë është njëherësh një multishkencë, e cila zhvillohet dhe modernizohet krahas shkencave të natyrës si biologjia, kimia e fizika, si dhe shkencave teknike. Qëllimi i këtij workshop-i për bujqësinë e zgjuar është njohja dhe demonstrimi i teknologjive dhe zgjidhjeve digjitale, që po transformojnë sektorin bujqësor.

Më pas prof.dr. Ibro ia dha fjalën akad. Vasil S. Toles,

demia e Shkencave e mbështet këtë takim, sepse ndjekja e përvojave europiane mbetet një faktor thelbësor për të tejkaluar sfidat dhe për të përfutur nga potenciali i plotë i sektorit, duke përdorur elementet e “bujqësisë së zgjuar”.

Partneriteti i ngushtë i ASHSH-së, i Komisionit të Përhershëm të Bujqësisë pranë saj me UBT-në, do të mundësojë këshillime të vazhdueshme të ekspertëve në implementimin e praktikave më të mira të bujqësisë së zgjuar, si dhe



Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në fjalën e saj përshëndetëse i njohu të pranishmit me realizimet, buxhetin dhe projektet e BB dhe FAO, lidhur me dixhitalizimin dhe Smart Agriculture, që janë duke u implementuar. Ajo shprehu mbështetjen e vazhdueshme të qeverisë shqiptare dhe donatorëve, si FAO dhe Banka Botërore, me të cilët tashmë kanë nisur puna për digjitalizimin e sektorit bujqësor, ndër të cilat edhe projektet DART, KRAD, etj.

Znj. Denaj vuri në dukje se tashmë portali i fermerit ofron informacione mbi tregjet dhe çmimet për mbi 40 produkte, duke rritur qasjen e fermerëve tanë në tregje të reja, ndërkohë që po punohet për modernizimin e sektorit drejt vizionit Bujqësia2030 dhe SHQIPËRIA2030 në BE.

Më tej, zonja Denaj theksoi rëndësinë që ka hapja e dyerve të Akademisë për

Kryetari i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar, z. Agim Rrapaj shprehu mirën-



johjen për ftesën për bashkëpunim me ASHSH-në. Ai e vuri theksin në nevojën për mbështetje të prodhuesve, që aplikojnë forma të ndryshme të Smart Agriculture, duke përmirësuar operacionet. KASH përfshin në vetvete 25 shoqata kombëtare dhe



torët e bujqësisë, blegtorisë, peshkimit dhe akuakulturës, agrobiznesit, agropërpunimit, bimëve mjekësore e aromatike dhe bletarisë, agroturizmit, agropylltarisë dhe mje-

vënë në dispozicion një staf të shquar akademik.

Ai foli më tej për rëndësinë e projektit për ndërkombëtarëzimin e arsimit të lartë dhe konkretisht mbështetjen nga qeveria në projektin e bashkëpunimit me Universitetin BOKU të Vjenës.

Në këtë veprimtari referuan 15 pjesëmarrës nga universitetet, MBZHR, Instituti i Meteorologjisë, ekspertë të projekteve të BB dhe FAO dhe projekteve COST dhe Horizon, të lidhur me dixhitalizimin dhe shtrirjen e Smart Agriculture në Shqipëri. Gjithashtu, u sollën disa përvoja konkrete të aplikimit të Smart Agriculture në rajone të ndryshme të vendit dhe në Kosovë, sidomos, ato të lidhura me ujitjen e zgjuar, plehërimin e zgjuar dhe përdorimin e informacionit të sensorëve në marrjen e vendimeve për ujitje, plehërim, trajtim me PMB apo për përshtatjen e kohës së vjeljes së frutave, etj.



Agjencia e Shteteve të Bashkura për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) po mbështet përmirësimin e konkurrueshmërisë në bujqësi, si një hap i rëndësishëm për zhvillimin e sektorit edhe në tregun ndërkombëtar.

Si pjesë e “Javës Globale të Sipërmarrjes”, koordinuar nga Start Up Albania, USAID në bashkëpunim me Universitetin Bujqësor të Tiranës, zhvilluan në ambientet e UBT-së një diskutim të hapur, me studentë dhe aktorë të linjës se si agrobiznesi mund të përparojë në tregun shqiptar dhe atë ndërkombëtar.

Diskutimi gjatë këtij takimi sollti së bashku studentë, agrobiznese dhe sipërmarrës, të cilët diskutuan mbi standardet

USAID mbështet rritjen e konkurrueshmërisë në bujqësi

e BE-së, teknologjitë e reja dhe potencialin e produkteve bujqë-

sore si vaji i ullirit, verërat dhe bimët aromatike mjekësore.

USAID, përmes një projekti të saj në mbështetje të bujqë-

sisë, po ndihmon që produktet shqiptare të përshtaten me

kërkesat e tregut të BE-së. Gjithashtu do të ndihmojë Shqipërinë të përshtatet me kërkesat e BE-së.

“Së bashku me prodhuesit shqiptarë, mund të rrisim më tej cilësinë e bujqësisë të Shqipërisë dhe mund ta sjellim Shqipërinë një hap më pranë integritimit në BE”, theksoi Dina Karic, shefe e projektit të USAID, “Compete SeBashku”.

Takimi vijoi me histori frymëzuese suksesi nga sipërmarrësit e rinj që janë përkushtuar bujqësisë, prezantimi i ideve të reja në sektorin bujqësor, teksta u ndanë rezultatet e pyetësorit “Mentimeter” për produktet agrobiznesore shqiptare të cilësisë së lartë, i cili u zhvillua gjatë “Javës Globale të Sipërmarrjes”.



KËNDI I EKSPERTIT

Kalendari bujqësor, muaji dhjetor 2024

Përgatitur nga Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari

Pamja e qiellit gjatë muajit dhjetor 2024

Më 1 dhjetor - Hëna e re. Hëna do të vendoset në të njëjtën anë të Tokës me Diellin

Kjo është koha më e mirë e muajit për të vëzhguar objektet të zbehta si galaktikat dhe grupimet e yjeve, sepse nuk ka dritë të hënës që të ndërhyjë.

Parashikimi i motit për muajin dhjetor 2024 në Tiranë (Zona bregdetare)

Table with columns: Dt., Temperatura e ajrit °C, Temp. reale që ndjehet °C, Shiu (mm, Orë), Era (Km/Orë, Drejtimi), UV Indeks, Zhvillimi i reve dhe reshjet, Simboli. Rows 1-31.

Parashikimi i motit për dhjetor 2024 në Korçë (Zona e ftohtë)

Table with columns: Dt., Temperatura e ajrit °C, Temp. reale që ndjehet °C, Shiu (mm, Orë), Era (Km/Orë, Drejtimi), UV Indeks, Zhvillimi i reve dhe reshjet, Simboli. Rows 1-31.

dhe nuk do të jetë e dukshme në qiellin e natës. Kjo fazë do të ndodhë në orën 07:21 UTC. Kjo është koha më e mirë e muajit për të vëzhguar objektet të zbehta si galaktikat dhe grupimet e yjeve, sepse nuk ka dritë të hënës që të ndërhyjë.

Më 7 dhjetor - Jupiteri në opozitë. Planeti gjigant do të jetë në distance më të afërta me Tokën dhe faja e tij do të ndriçohet plotësisht nga Dielli.

Do të jetë më e ndritshme se në çdo kohë tjetër të vitit dhe do të jetë e dukshme gjatë gjithë natës. Kjo është koha më e mirë për të parë dhe fotografuar Jupiterin dhe hënat e tij. Një teleskop i mesëm duhet të jetë në gjendje t'ju tregojë disa nga detajet në brezat e reve të Jupiterit. Një palë dylbi të mira mund t'ju lejojë të shihni katër hënat më të mëdha të Jupiterit, që shfaqen si pika të ndritshme në të dyja anët e planetit.

Më 13 - 14 dhjetor - Shiu meteor i Geminids. Geminids është mbreti i shirave të meteorëve. Konsiderohet nga shumë njerëz si shiu më i mirë në qiej, duke prodhuar deri në 120 meteorë shumëngjyrësh në orë në kulmin e tij. Ai prodhohet nga mbeturinat e lëna pas nga një asteroid i njohur si 3200 Phaethon, i cili u zbulua në vitin 1982. Dushi zhvillohet çdo vit nga 7-17 dhjetor. Kulmin e ka këtë vit natën e datës 13 dhe mëngjesin e datës 14. Hëna pothuajse e plotë do të bllokojë të gjithë, përveç meteorëve më të ndritshëm këtë vit. Por nëse jeni të durueshëm, mund të jeni ende në gjendje të kapni disa të mira. Shikimi më i mirë do të jetë nga një vend

Treguesit mesatarë klimatike gjatë muajit dhjetor 2024

Table with columns: Treguesit, Tiranë, Korçë, Vlorë, Shkodër, Dibër, Gjirokastrë. Rows: Temperatura e ajrit, Mesatare (°C), Maksimale (°C), Minimale (°C), Më e larta gjatë viteve (°C), Më e ulta gjatë viteve (°C), Numuri i ditëve me Temperaturë +30°C (Ditë dhe %), Numuri i ditëve me Temperaturë +18°C (Ditë dhe %), Numuri i ditëve me Temperaturë nën-0°C (Ditë dhe %), Era, Shpejtësia e erës (Km/Orë), Temperatura e erës (°C), Reshjet (Shiu), Shi (mm), Numuri i ditëve me shi (Ditë dhe %), Sasia rekord e shiut gjatë një dite (mm dhe vit), Reshje dëborë cm, Lagështia e ajrit (%), Shikueshmëria (Km), Mbulimi i qiellit me re (%), UV index, Orë me diell nëDitë, Gjatësia e ditës (Orë), Vlerësimi i muajit.

i errët pas mesnatës. Meteorët do të rrezatojnë nga konstelacioni i Binjakëve, por mund të shfaqen kudo në qiell. Më 15 dhjetor - Hëna e plotë. Hëna do të jetë e vendosur në anën e kundërt të Tokës nga Dielli dhe faja e saj do të jetë plotësisht e ndriçuar. Kjo fazë do të ndodhë në orën 10:01 UTC. Kjo hënë e plotë ishte e njohur nga fiset e hershme vendase amerikane si Hëna e Ftohtë, sepse kjo është koha e vitit kur ajri i ftohtë i dimrit vendoset dhe netët bëhen të gjata dhe të errëta. Kjo hënë ka qenë e njohur edhe si Hëna e Netëve të gjata dhe Hëna para Krishtlindjeve. Më 21 dhjetor - Solstici i dhjetorit. Solstici i dhjetorit do të ndodhë në orën 10:17

UTC. Poli i Jugut i tokës do të jetë i anuar drejt Diellit, i cili do të ketë arritur pozicionin e tij më jugor në qiell dhe do të jetë drejtpërdrejt mbi Tropikun e Bricjapit në 23,44 gradë gjerësi jugore. Kjo është dita e parë e dimrit (solstici dimëror) në hemisferën veriore dhe dita e parë e verës (solstici i verës) në hemisferën jugore. Më 21- 22 dhjetor - Dushi meteorësh Ursids. Ursids është një shi i vogël meteorësh që prodhon rreth 5-10 meteorë në orë. Ai prodhohet nga kokrrat e pluhurit të lëna pas nga kometa Tuttle, e cila u zbulua për herë të parë në 1790. Dushi zhvillohet çdo vit nga 17-25 dhjetor. Ai do të arrijë kulmin këtë vit në natën e datës 21 dhe mëngjesin e datës 22. Hëna në rënie do të

Kalendari, fazat e hënës dhe shënjat astrologjike për muajin dhjetor 2024

Table with columns: Dt., Dita, Dita e Vitit, Dielli (Lind, Perëndon), Zgjatja e ditës, Hëna (Lind, Perëndon), Fazat e Hënës (Faza, %, Dita), Shënjat Astrologjike. Rows 1-31.

bllokojë shumë nga meteorët më të zbehtë këtë vit. Nëse jeni të durueshëm, duhet të jeni ende në gjendje të kapni disa nga ato më të ndritshme. Shikimi më i mirë do të jetë vetëm pas mesnatës nga një vend i errët larg dritave të qytetit. Meteorët do të rrezatojnë nga njësisia Arusha e Vogël, por mund të shfaqen kudo në qiell. Më 25 dhjetor - Merkuri në zgjatjen më të madhe perëndimore. Planeti Merkuri arrin zg-

jatjen më të madhe perëndimore prej 22 gradë nga Dielli. Kjo është koha më e mirë për të parë Merkurin pasi ai do të jetë në pikën më të lartë mbi horizont në qiellin e mëngjesit. Kërkoni planetin poshtë në qiellin lindor pak para lindjes së diellit. Më 30 dhjetor - Hëna e re. Hëna do të vendoset në të njëjtën anë të Tokës me Diellin dhe nuk do të jetë e dukshme në qiellin e natës. Kjo fazë do tëndodhë në orën 23:26 UTC.

Parashikimi i motit për muajin dhjetor 2024 Dhjetori në Tiranë do të ndikohet nga klima bregdetare mesdhetare. Në Tiranë në dhjetor mund të prisni: si rregull reshje shiu, kohë pas kohe stuhi, herë pas here mjegull, rrallë borë dhe mot i shpejtë. Gama e temperaturave mesatare të ditës do të jetë rreth 10°C dhe (Vijon në faqen 14)



PËRFITO

NORMAT MË TË MIRA
TË INTERESIT



Depozita e Artë

- Hap depozitën **36 Muaj**
- Normë interesi deri në **4.5%** në Lekë dhe **3.5%** në Euro

Skano për
më shumë

